**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË**

*Nr.* 1293/1 *Prot.*

*Korçë, më* 15.09 *2022*

**SHPALLJE KONKURSI PËR DREJTOR INSTITUCIONI ARSIMOR TEK SHKOLLA**

**"OSMAN GJINI" MOLLAS ZVAP CERRIK**

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, , Urdhrit te Ministrit te Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr 31 datë 28.01.2020 "*Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore*", Udhëzimit Nr 30 datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar" i ndryshuar, kreut I, gërma A dhe gërma B, të Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar" i ndryshuar,

Shpallet konkursi tek Shkolla;

**"Osman Gjini Mollas" ZVAP Cerrik**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues instituconi arsimor :**

Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar"dhe vleresim jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit.

Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.

**Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor;**

- Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të **(sipas modelit të shtojcës 1/Udhëzimi Nr.2 datë 28.01.2020, i ndryshuar)**
- Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së punës(e noterizuar)
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID)
- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 4 të Udhëzimit).

Adresa: " Dhimitër Denasi"
Lgj. 18, AL 7001, Korçë
Website: http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/

- Certifikatën e drejtuesit të IAPP ose vërtetim nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për ta kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore **(sipas shtojcës nr 2 bashkëlidhur udhëzimit)**
- Vërtetim nga institucioni ku punon se aplikanti nu ka ka masë disiplinore në fuqi.
- Deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të institucionit arsimor, ku po konkurron për pozicioni drejtues (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es) **(sipas shtojcës nr 3 bashkëlidhur udhëzimit).**

**Aplikanti për drejtues institucioni arsimor duhet të paraqesë në ZVAP Cerrik dosjen personale me dokumentacionin e sipërshënuar me anë të shërbimit postar, nga data 15.09.2022 deri 26.09.2022**

**Pas shpalljes së procedurave dhe publikimit në faqen zyrtare nga DRAP Korçë, të njoftohet zyrtarisht ZVAP Cerrik, për shpalljen e këtyre procedurave edhe në faqen zyrtare të ZVAP Cerrik dhe ambjenteve publike të saj.**

**DREJTORE**

**VINJOLA ROTA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar KORÇË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT